



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18.02.2025

Nr: 111

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR DENONCIMIN NR. 5 ID, DATË
10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE**

Sot më datë 18.02.2025 Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Zj. Belinda Balluku**
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Zj. Ogerta Manasterliu
Ministër i Arsimit dhe Sportit

Zj. Mirela Kumbaro
Ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Z. Bledi Çuçi
Nënkryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Z. Taulant Balla
Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Palë e interesuar: **Partia Socialiste e Shqipërisë**
Përfaqësuar nga zj. Eelena Xhina, përfaqësues ligjor i Partisë Socialiste të Shqipërisë

OBJEKT: Konstatimi i shpërdorimit të burimeve publike dhe njerëzore në mbështetje të subjekteve zgjedhore, angazhimi në fushatë zgjedhore para afatit të caktuar me ligj

Nr: 111

Data: 18.02.2025

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ bazuar denoncimin nr. 5 ID, datë 10.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe pika 2, neni 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nënpika 1.3, pika c, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Partia Demokratike më datë 10.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet protokollit, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 5 ID.

Në këtë denoncim PD parashton si vijon:

“Nga denoncimet dhe raportimet e publikuara në media të ndryshme, Partia Demokratike ka konstatuar se drejtuesit politik të PS-së në disa qarqe si Belinda Balluku, Ogerta Manasterliu, Mirela Kumbaro dhe Bledi Çuçi kanë qenë në Athinë dhe Janinë ku janë hapur zyra informuese për të asistuar të gjithë shqiptarët që jetojnë jashtë vendit për të marrë pjesë në zgjedhjet e 11 majit.

Bledi Çuçi ka publikuar në llogarinë e tij foto nga takimi ku shihet se është krijuar një zyrë asistence. Krahas fotove, Bledi Çuçi “Athinë - Në zyrën e hapur këtu në Atikën veriore ku ka nisur regjistrimi i votuesve jashtë vendit. Kushdo që nuk e kryen dot vetë këtë regjistrim në faqen e KQZ le të paraqitet në këto zyra për asistencë”. Ministri i Shtetit Taulant Balla në rrjetin e tij social instagram ka publikuar se në datë 18 janar 2025, ora 11:00 do të gjendet në Rimini, Itali, për të takuar shqiptarët”.

Me vendimin nr. 102, datë 14.02.2025, të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative për raportimin e veprimtarive publik., për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim i’u kërkua personave përgjegjës në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe Kuvendin e Shqipërisë, të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

KQZ administroi pretendimet e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, dërguara me e-mail në KQZ. Subjektet e denoncimit në tërësi deklaruan se “Në këto takime pjesëmarrja e personave subjekt denoncimi nuk ka qenë në cilësinë apo funksionet e tyre shtetërore si dhe për këto aktivitete në asnjë rast nuk janë përdorur fonde publike apo burime të tjera njerëzore apo materiale të institucioneve përkatëse që drejtojnë.

Vizitat në cilësinë dhe statusin e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe drejtuesve politik brenda apo jashtë vendit, nuk konsiderohen fushatë elektorale, në kushtet kur në zbatim të pikës 1 të nenit 91, ende nuk ka kandidatë të regjistruar të partive politike apo koalicioneve zgjedhore”.

Më datë 18.02.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ. Në këtë seancë morën pjesë përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë së Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Nuk u paraqitën përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Gjithashtu në këtë seancë ishin të pranishëm përfaqësues të subjektit kërkues të Partisë Demokratike përfaqësuar nga z. Franci Nuri dhe si palë e interesuar Partia Socialiste e Shqipërisë, me përfaqësuese zj. Elena Xhina.

Përfaqësuesit e Institucioneve subjekt denoncimi, në tërësi deklaruan se, z. Balla, z. Çuçi, zj. Kumbaro, zj. Manestirliu dhe zj. Balluku, nuk kanë marrë pjesë në këtë aktivitet në cilësinë apo funksionet e tyre si Ministër, si dhe për këtë aktivitet nuk kanë kryer asnjë shpenzim që lidhet me fondet publike apo me detyrën e tyre si anëtarë të Qeverisë.

Nga hetimi administrativ u provua se subjektet e këtij denoncimi kanë marrë pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Athinë. Nga deklaratimet e palëve në seancë publike dhe nga hetimi administrativ nuk u arrit të provohet se subjektet e denoncuar të kenë marrë pjesë në këtë takim në cilësinë e funksionit të tyre si Ministër si dhe të kenë përdorur fonde publike të institucionit që ata drejtojnë.

Neni 91 të Kodit Zgjedhor, përcakton se *”Nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor”*.

Për sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi, pasi nuk bazohet në prova konkrete në lidhje me shpërdorimin e funksionit publik të tyre si Ministër si dhe përdorim të burimeve publike të Institucionit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ të denoncimit nr. 5, datë 10.02.2025, të Partisë Demokratike.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI